



3942
Rt. 26.07.22.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE
DHE KRIZAVE

Nr. 8231 Prot.

Elbasan, më 15.07.2022

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Adresa: Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", në lidhje me ligjshmërinë e vendimit tuaj **Nr. 55 datë 30.06.2022** "*Për miratimin e dokumentacionit teniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga fatkeqësi natyrore*", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda **PERRIU**





REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE
DHE KRIZAVE

Nr. 823/1 Prot.

Elbasan, më 13.7.2022

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZH
Adresa: Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në lidhje me ligjshmërinë e vendimit tuaj **Nr. 55 datë 30.06.2022** "Për miratimin e dokumentacionit teniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga fatkeqësi natyrore". Para se të shprehemi mbi ligjshmërinë e aktit tuaj kërkojmë të na dërgoni dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të parashikuar në **V.K.M Nr. 329 datë 16.05.2012** "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore". (Dokumentacioni duhet të jetë i njësuar me origjinalin).

Deri në dërgimin e dokumentacionit, akti i juaj mbetet i pakonfirmuar.



PREFEKTI

Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Dt.04.07.2022

Nr. ____ prot

Nr.55 dt.30.06.2022

**PER MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR PER AKORDIMIN E
NDIHMES FINANCIARE PER FAMILJET QE KANE PESUAR DEME NE BANESAT E
TYRE NGA FATKEQESI NATYRORE**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore .”, ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, si dhe VKM-së nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “, Kreu III/3/e, Pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar .” Për dhenie të ndihmës financiare, për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (rënie zjarri) për banesën e Z.Selman Bahiti banorë i qytetit Librazhd, Bashkia Librazhd, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 30.06.2022 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Librazhd ,për mbështetje financiare për shtetasin Selman Bahiti banorë i qytetit Librazhd, për shkak se banesa e tij e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (rënie zjarri.)
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur nga specialistët e Bashkisë Librazhd, për banesën e të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (rënie zjarri.)
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Selman Bahiti ndihmëm emergjente në vlerën financiare prej 82 500 lekë nga buxheti i Bashkisë Librazhd, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli Bashkiak Librazhd për vitin 2022.
4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Selman Bahiti ,banesa e të cilit është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329 date 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për të ardhur në ndihmë familjes së Z.Selman BAHITI, banesa e të cilit është dëmtuar për shkak fatkeqësisë natyrore (rënie zjarri)
6. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Sektori i Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
7. Ky vendim hynë në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**Sek.i Keshillit
Elson Malluta**

**KRYETARI I KËSHILLIT
Shefki Bahiti**

